



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 632 prot.

Roskovec, më 31.01.2024

VENDIM

Nr. 4, datë 30.01.2024

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRVENDORE PËR
MENAXHIMIN E LANDFILLIT (DEPOZITIM, PESHIM & MIRËMBAJTJE E
RRUGËS HYRËSE) NË IMPIANTIN E MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER**

Mbështetur në nenet 3, 8, 9, 14, 23, 32, 33, 54 shkronja "gj" dhe "k" të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 90, datë 31.10.2023 "Për dhënien e dakortësisë për marrjen në përdorim të landfillit të mbetjeve urbane të administruar nga Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Roskovec, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e dokumentit "Marrëveshje Bashkëpunimi Ndërvendor për menaxhimin e Landfillit (depozitim; peshim; pastrim&mirëmbajtje të rrugës hyrëse) në Impiantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier" të lidhur midis Bashkisë Fier (nr 260 prot, datë 12.04.2024), Bashkisë Lushnje (nr 439 prot. datë 16.01.2024), Bashkisë Roskovec (nr 260 prot, datë 16.01.2024), Bashkisë Divjakë (nr 256 prot, datë 16.01.2024), Bashkisë Patos (nr 110 prot, datë 16.01.2024), Bashkisë Mallakastër (nr.199 prot, datë 16.01.2024).
2. Ngarkohet për zbatim ekzekutivi i Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Mjedisit (Pastrim, Gjelbërim dhe Kompostim të Mbetjeve Bimore) e Bashkisë Roskovec.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

